



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0480

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga UD. Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Panelist Individual, duke vendosur sipas ankesës së OE “GJEO-PROJEKT” SH.P.K, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “024 Blerja e paisjeve Gjeodezike per nevoja te DPKSHP-së” me numër të prokurimit 635-25-3196-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PEJËS”, më 22/07/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar, ankesat e “GJEO-PROJEKT” SH.P.K, me nr. 2025/0480, e datës 12.06.2025, ndërsa vendimi i AK “KOMUNA E PEJËS”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “024 Blerja e paisjeve Gjeodezike per nevoja te DPKSHP-së” me numër të prokurimit 635-25-3196-1-2-1.

1. Anullohet në tërësi, aktiviteti i prokurimit “024 Blerja e paisjeve Gjeodezike per nevoja te DPKSHP-së”, me numër të prokurimit 635-25-3196-1-2-1, në mungesë të ofertave të përgjegjshme. Nëse autoriteti kontraktues ka interes këtë aktivitet të prokurimit **mund ta ri-tenderoj**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.

3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 16.04.2025, "KOMUNA E PEJËS", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "024 Blerja e paisjeve Gjeodezike per nevoja te DPKSHP-së" me numër të prokurimit 635-25-3196-1-2-1. Ndersa me datën 28.05.2025 ka publikua Njoftimin mbi vendimin e AK per dhënie te kontratës. OE "AGEO & CO" SH.P.K.,

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur; Lloji i kontratës: furnizim Vlera e parashikuar e kontratës: 16,000.00 €.

Me 31.05.2025 OE "GJEO-PROJEKT" SH.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 02.06.2025 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12.06.2025, OE "GJEO-PROJEKT" SH.P.K, ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0480/2025 lidhur me aktivietin e prokurimit "024 Blerja e paisjeve Gjeodezike per nevoja te DPKSHP-së" me numër te prokurimit; 635-25-3196-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "GJEO-PROJEKT" SH.P.K, janë parashtruar si në vijim:

Me datën 28.05.2025, jemi njoftuar nga AK, që per aktivitetin e prokurimit 024 Blerja e paisjeve Gjeodezike per nevoja te DPKSHP-së, me numer prokurimi: 635-25-3196-1-2-1, është shpallur fitues OE AGEO & CO SH.P.K, me vleren e ofertes:7,650.00€.

Operatori ekonomik GJEO-PROJEKT SHPK, ka ofertuar me çmimin e ofertes prej:6,500.00€

Në arsyet e eliminimit te OE GJEO-PROJEKT SHPK, do te pergjigjemi si vijon:

Pretendimi 1: Në kuadër te specifikimeve teknike për GPS, janë kërkuar pikat si vijon:

- RESIVERI-Te suportoj deri ne 1400 sinjale satelitore
- Te suportoj GPS, GLONASS, BDS, GALILEO, SBAS, QZSS, L-Band.
- Te suportoj WIFI, Blututh dhe Multiprotocol komunikim UHF
- Resiveri te jete dy frekuenca, njekohesisht te mund te perdoret si rover ne CORS, por edhe baze ose rover ne UHF.
- Te suportoj VRS, FKP, MAC dhe NTRIP Protocol
- Te kete te integruar UHF te brendshem ne resiver

- Te kete optionper matje te pjerrte IMU TILT deri ne 60 shkalle
- Ne RTK saktesia te jete jo me pakse 1 cm ne 2D dhe jo me pakse 2 cm ne 3D.

Njëra nga arsyet e eliminimit të OE GJEO-PROJEKT SHPK, është arsyeja që GPS-ët nuk suportojnë fajllat VRS, FKP, MAC dhe Ntrip Protocol.

Ky arsyetim nuk qëndron dhe shihet qartë që komisioni vlerësues nuk ka vlerësuar oferten tonë në tërësinë e saj.

Tek Fajlli i emëruar me emër: Manuali dhe specifikat e GPS-it, në faqen 27, shihet qartë që GPS-ët e kërkuar e plotësojnë kërkesën e DT, fotografia në vijim:

Pretendimi 2: Në kuadër të specifikimeve teknike për Kontroller është kërkuar që kontrolleri të ketë , Ekranin touch screen dhe tastaturë alfanumerike-fizike.

Në arsyen e eliminimit të OE GJEO-PROJEKT SHPK, keni cekur që Kontrolleri i ofruar nuk është kontroller që ofron opsione alfanumerike.

Ky pretendim i AK, nuk qëndron sepse në oferten e prezentuar nga GJEO-PROJEKT, tek pjesa e përshkrimit të qmimeve shihet qartë që është vendosur qmimi edhe për kontrollerin dhe softuerin që instalohet në kontroller dhe është ofruar komplet Broshura dhe Manuali për punën e kontrollerit dhe softuerit i cili instalohet në kontroller.

Pas kërkesës për rishyrtim për këtë pikë, AK, na është përgjigjur me arsyen që nuk kanë pasur ndonjë fotografi për konstatim. Vlerësojmë që manualët dhe broshurat punohen nga prodhuesi dhe nëse AK për vlerësim ka pasur nevojë edhe për fotografi atëherë konform Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L- 237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht NENIT 72-Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë., AK ka pasur mundësi të kërkojë sqarime shtesë dhe tju prezentohen edhe fotografit.

Pretendimi 3: Në kuadër të specifikimeve teknike janë kërkuar edhe aksesoret dhe pjesë përcjellëse për punë normale në terren si baze dhe rover (tripod, tribach, conector dhe stake pole).

Në arsyen e eliminimit keni cekur që mungojnë aksesoret përcjellës (tripod, tribach, conector dhe stake pole).

Konsiderojmë që edhe ky pretendim i AK-së, nuk është i qëndrueshëm sepse në vetë paramasën e bashkëngjitur shihet qartë që OE GJEO-PROJEKT SHPK, ka ofruar çmimin edhe për aksesoret,

Duke e analizuar paramasën shihet qartë që ju si AK keni kërkuar dy Sete të GPS-it, me mundësi operimi Rover dhe Base, prandaj aksesoret si stake pole, tribach, tripod dhe conector, janë aksesoret në kuadër të setit. Prandaj tendenca e juaj e ndarjes së seteve në pjesë të veqanta nuk është e qëndrueshme dhe e arsyeshme. Ju njoftojmë që në kuadër të setit përpos aksesoreve të lartëcekur janë edhe pjesët si mbushësi i GPS-it, mbushësi i kontrollerit, kutija mbajtëse e GPS-it, antenna për funksionim të GPS si Base dhe Rover etj, por për të njëjtat nuk janë ofruar specifika dhe katalogje sepse nënkuptohet që në setin e një GPS-i Base dhe Rover këto aksesore janë të domosdoshëm.

Nëse komisioni vlerësues ka pasur ndonjë dyshim ose hamendësim që mos ndoshta aksesoret shtesë nuk janë pjesë e setit, ju si AK-së keni pasur mundësi të kërkonit sqarime nga OE konform: Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht NENIT 72-Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë.

Nga kjo shihet qartë që AK, ka shkelu ligjin e prokurimit dhe nuk ka konsumuar të gjitha elemente me qëllim të vlerësimit sa më transparent të ofertave dhe trajtimin e barabartë të OE.

Pretendimi 4: OE i shpallur fitues, për pronar të biznesit sipas informatave në ARBK, për pronar dhe përfaqësues të autorizuar e ka z.Kujtim Vuqitema.

Përfaqësuesi i autorizuar

Për OE të shpallur fitues, Deklaratën Nën Betim e ka nënshkruar z.Vllaznim Vuqiterna. Nga dokumentacioni i OE të rekomanduar për kontratë mungon autorizimi ku deshmohet që të drejten e nënshkrimeve të dokumentave zyrtare për OE AGEO&CO SHPK e ka Vllaznim Vuciterna. Kjo pikë bie ndesh shprehimisht me Nenin 109 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Kjo çështje është sqaruar edhe tek Opinioni i KRPP-së, ku në Opinionin Nr.14, datës:24.10.2023.

Duke u referuar të pretendimet si më sipër, OE “GJEO-PROJEKT” SH.P.K, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092. Neni 1 i LPP-së, Neni 6 i LPP-së, Neni 7 i LPP-së, Neni 59 i LPP-së, Neni 60 i LPP-së, Neni 65 i LPP-së, Neni 61 i LPP-së, Neni 69 i LPP-së, Neni 72 i LPP-së, Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju që të nxjerrni: VENDIM Të APROVOHET, në tërësi si e bazuar ankesa e OE GJEO-PROJEKT SHPK Të detyrohet AK- Kuvendi Komunal Pejë që lëndën të e rikthejë në ri-vlerësim. Të detyrohet AK- Kuvendi Komunal Pejë, bazuar në nenin 105, par.2.10 i LPP-së, që oferta e OE të rekomanduar për dhënje të kualifikohet si e papërgjegjshme dhe që OE GJEO PROJEKT SHPK të shpallet fitues.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim për OE “GJEO-PROJEKT” SH.P.K, Operatori Ekonomik “GJEO-PROJEKT SH.P.K” me datën 31.05.2025, ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: “Blerja e paisjeve gjeodezike për nevojat e DPKSHP-se” Nr. të Prok: 635-25-3196-1-2-1 dhe nr i brendeshëm 635-24-015-1-2-1.

Autoriteti Kontraktues, me datën 02.06.2025 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Duke iu referuar ankesës tuaj të paraqitur me datë 02.06.2025 në lidhje me aktivitetin e prokurimit të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Komuna e Pejës, ju njoftojmë se pas shqyrtimit të hollësishëm të pretendimeve tuaja, komisioni profesional ka vlerësuar se ankesa nuk është e bazuar në fakte dhe në dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (me ndryshime dhe plotësime të mëvonshme).

Vendimi është marrë pas analizimit të dokumentacionit të tenderit dhe ofertave të pranuar, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, përkatësisht në:

1.Aneksi 1, pika 1.1 - Specifikimet teknike të detyrueshme (paramasa dhe parallogaria):

Është evidentuar se përshkrimi i pajisjeve të paraqitura në modelin e rrjetit nuk përputhet me përshkrimin teknik të kërkuar në dokumentacionin e tenderit, çka përbën mospërputhje me kërkesat thelbësore të specifikuara nga Autoriteti Kontraktues.

2.Aneksi 1, pika 1.3 - Aksesorët dhe pjesët përcjellëse:

Nuk janë paraqitur fotografi dhe dëshmi përkatëse për aksesorët për punë në terren (bazë, rover, tripod, tribach, connector, Stake pole). Kjo mungesë pamundëson verifikimin e përputhshmërisë teknike të pajisjeve të ofruara me specifikimet e kërkuara.

3.Aneksi 1, pika 1.3 - Kontrollhiesi (controller):

Nuk janë dorëzuar fotografi apo katalogë të kontrolluesit, që paraqet mangësi në dokumentacionin teknik dhe pamundëson vlerësimin e përputhshmërisë së ofertës me kërkesat minimale teknike.

4.Mungesa e kërkesës për qasje në dokumente:

Operatori ekonomik nuk ka bërë kërkesë zyrtare për qasje në dokumentacionin e ofertës së operatorit fitues, l siç parashihet me nenin 10 dhe nenin 59 të LPP-së.

Rrjedhimisht, deklarata nën betim e operatorit fitues është e vlefshme dhe mbetet përgjegjësi ekskluzive e palës që e ka paraqitur.

Duke u bazuar në të lartpërmendurat, ju informojmë se ankesa juaj nuk mund të merret parasysh dhe konsiderohet e pabazuar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 23.06.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0480. Lidhur me ankest nr. 0480/25 me datën 28.06.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të tenderit, ofertave të paraqitura dhe pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtues vlerëson se si Operatori Ekonomik ankues, ashtu edhe Operatorët tjerë pjesëmarrës, përfshirë edhe atë të rekomanduar për kontratë nga Autoriteti Kontraktues , nuk i plotësojnë kriteret e përgjegjshmërisë sipas Dosjes së Tenderit. Po ashtu, njëri nga operatorët pjesëmarrës konsiderohet palë pa interes, pasi nuk ka ushtruar asnjë mjet ligjor kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues. Në këto rrethana, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të vlerësohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe të rekomandohet që aktiviteti i prokurimit të anulohet për shkak se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme.

Raportin e ekspertizës me nr.0480/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, si dhe OE nuk pajtohet.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “GJEO-PROJEKT” SH.P.K, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0480 ka vlerësuar si në vijim

Pretendimi ankimor nr. 1 – Në këtë pretendim ankimor, OE ankues "GJEO-PROJEKT SHPK" pretendon se është përjashtuar në mënyrë të pajustificuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se pajisja e ofertuar nuk i mbështet formatet e kërkuara të transmetimit të të dhënave për GPS (konkretisht: VRS, FKP, MAC dhe NTRIP Protocol), të cilat ishin të përcaktuara si kërkesa në specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit.

OE ankues thekson se ky konstatim është i pabazuar, pasi në dokumentin teknik të titulluar "Manuali dhe specifikat e GPS-it", konkretisht në faqen 27, është paraqitur qartë se pajisja mbështet të gjitha protokollat e kërkuara nga AK, përfshirë:

GPS Output Format: VRS, FKP, MAC

Network Model: Ntrip fully supportable

Për ta mbështetur këtë pretendim, OE ka bashkangjitur pamjen përkatëse nga katalogu teknik, ku, sipas tij, dëshmohet qartë përputhshmëria me kërkesat e DT-së dhe rrjedhimisht ai kërkon që përjashtimi të konsiderohet i pabazuar dhe oferta e tij të rivlerësohet.

Përgjigje në pretendimin ankimor Nr. 1

Në cilësinë e ekspertit shqyrtues të angazhuar për trajtimin e kësaj ankese, pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit si dhe pretendimit të paraqitur nga Operatorit Ekonomik Ankues “GJEO-PROJEKT” SHPK, lidhur me arsyen e eliminimit të tij për mosmbështetje të protokolleve të kërkuara për GPS (VRS, FKP, MAC dhe NTRIP), jap vlerësimin si më poshtë:

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se eliminimi i ofertës së tij është bërë në mënyrë të pajustificuar, me arsyetimin se GPS-i i ofertuar nuk mbështet protokollat e kërkuara në Dosjen e Tenderit. Për të mbështetur këtë pretendim, OE ka bashkangjitur dokumentin teknik të titulluar: “8. Manuali dhe Specifikat teknike të GPS-it”, ku në faqen përkatëse (siç paraqitet në figurën e bashkangjitur) citohet qartë se pajisja e ofertuar:

·Në rubrikën “GPS Output Format” mbështet: VRS, FKP, MAC

·Në rubrikën “Network Model” është deklaruar se: “Ntrip fully supportable”

Pas shqyrtimit të këtij dokumenti, vlerësoj se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi nga përmbajtja e manualit rezulton qartë se pajisja teknike i plotëson kërkesat e përcaktuara në DT sa i përket formateve/protokolleve të transmetimit për sistemin GPS.

Rrjedhimisht, konsideroj se arsyetimi për eliminimin e OE ankues lidhur me këtë pikë nuk qëndron, Andaj dhe ky pretendim vlerësohet të jetë i bazuar .

Pretendimi ankimor nr. 2 – Në këtë pretendim ankimor, OE ankues "GJEO-PROJEKT SHPK" kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues për përjashtimin e ofertës së tij me arsyetimin se kontrolleri i ofertuar nuk ka tastierë alfanumerike-fizike, ashtu siç ishte kërkuar në specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit (DT).

OE ankues argumenton se ky konstatim i AK-së është i pabazuar, pasi në ofertën e dorëzuar janë përfshirë dokumente të qarta që dëshmojnë përputhshmërinë e pajisjes së ofertuar me kërkesat teknike. Konkretisht, në pjesën e përshkrimit të çmimeve, është vendosur në mënyrë eksplicite çmimi për kontrollerin me softuerin e instaluar, si dhe është bashkangjitur broshura/manuali përkatës që përmban fotografi të pajisjes, ku shihet tastiera dhe ekranit touch screen.

Për këtë arsye, OE konsideron se eliminimi është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, pasi autoriteti ka pasur mundësi të verifikojë në mënyrë të qartë përmbushjen e kësaj kërkesë teknike, qoftë përmes dokumentacionit të ofertës, qoftë përmes kërkesës për sqarim shtesë nëse do të kishte ndonjë paqartësi.

Përgjigje në pretendimin ankimor Nr. 2 : Në cilësinë e ekspertit shqyrtues të angazhuar për trajtimin e kësaj ankese, pas analizimit të dokumentacionit të ofertës së Operatorit Ekonomik Ankues “GJEO-PROJEKT” SHPK, si dhe pretendimit të paraqitur në lidhje me mungesën e tastierës alfanumerike-fizike në kontrollerin e ofertuar, jap vlerësimin si më poshtë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit, kontrolleri duhej të kishte:

- Ekran touch screen, dhe
- Tastaturë alfanumerike-fizike

Në funksion të shqyrtimit të këtij pretendimi, kam analizuar dokumentin PDF 9 – Manuali dhe Specifikat e kontrollorit, i dorëzuar nga OE në ofertën e tij. Nga përmbajtja e këtij dokumenti nuk rezulton të ketë ndonjë informacion apo përshkrim teknik që dëshmon se kontrolleri i ofertuar posedon tastaturë alfanumerike-fizike, siç është kërkuar në DT.

Në këtë kontekst, vlerësoj se Autoriteti Kontraktues ka vepruar drejt kur ka eliminuar OE-në për mospërmbushje të kësaj kërkesë teknike, duke qenë se dokumentacioni i ofertës nuk e dëshmon përputhshmërinë me kriterin për tastaturën alfanumerike-fizike.

Bazuar në sa u tha më sipër, vlerësoj se pretendimi ankimor është i pa bazuar

Pretendimi ankimor nr. 3 – Në këtë pretendim ankimor, OE ankues “GJEO-PROJEKT” SHPK konteston vendimin për eliminimin e ofertës së tij me arsyetimin se nuk janë përfshirë aksesoret përcjellës për punë në terren si: tripod, tribrach, connector dhe stake pole – të cilët ishin të specifikuar si kërkesë në Dosjen e Tenderit (DT).

OE ankues konsideron se kjo arsye e eliminimit nuk qëndron, pasi në ofertën e dorëzuar ka përfshirë qartësisht çmimin për aksesoret e kërkuar. Konkretisht, në dokumentin e çmimeve, përkatësisht në paramasën nr. 1.3, është përfshirë zëri: “Aksesorë dhe pjesë përcjellëse për punë normale në terren si bazë dhe rover (tripod, tribrach, conector dhe stake pole)”, me sasinë, përshkrimin dhe çmimin përkatës për dy sete të tilla.

Për të mbështetur këtë pretendim, OE ka bashkëngjitur si dëshmi pamjen përkatëse të paramasës nga dokumentacioni i ofertës, ku është qartësisht i shënuar ky zë dhe përbërësit e tij.

Sipas OE-së, kjo dëshmon se kërkesa e AK-së është përmbushur dhe aksesorët janë të përfshirë në mënyrë të veçantë dhe transparente në dokumentacionin e ofertës.

Prandaj, OE ankues kërkon që ky pretendim të merret parasysh dhe të rivlerësohet në mënyrë objektive përmbushja e kërkesave teknike, duke vlerësuar dokumentacionin e ofruar në tërësi.

Përgjigje në pretendimin ankimor Nr. 3: Në cilësinë e ekspertit shqyrtues të angazhuar për trajtimin e kësaj ankese, pas analizimit të dokumentacionit të ofertës dhe përmbajtjes së pretendimit të Operatorit Ekonomik Ankues “GJEO-PROJEKT” SHPK, në lidhje me mospërfshirjen e aksesorëve përcjellës për punë në terren (tripod, tribrach, connector, stake pole), jap vlerësimin si më poshtë:

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se ka përfshirë këto pajisje në ofertën e tij dhe për këtë qëllim referon në pozicionin 1.3 të tabelës së çmimeve, ku është shënuar përshkrimi: “Aksesorë dhe pjesë përcjellëse për punë normale në terren si bazë dhe rover (tripod, tribach, conector dhe stake pole)”, me sasinë dhe çmimin përkatës.

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës, konkretisht dokumentit përkatës të bashkëngjitur në PDF, rezulton se OE nuk ka dorëzuar specifikimet teknike të detajuara për këto aksesorë, siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit. Konkretisht, në kërkesën 2 të DT-së thuhet qartë: “Operatori ekonomik ofron specifikimin teknik detal të pajisjeve të ofruara” – gjë që në këtë rast nuk është përmbushur.

Për rrjedhojë, pavarësisht faktit që pozicioni është shënuar në përshkrimin e çmimeve, mungesa e dokumentacionit teknik mbështetës (si manuale, broshura ose të dhëna teknike për pajisjet e ofruara) përbën mospërmbushje të kërkesave themelore teknike, dhe e pamundëson AK-në të verifikojë në mënyrë objektive përputhjen me specifikimet e kërkuara.

Bazuar në sa u tha më sipër, vlerësoj se pretendimi ankimor është i pa bazuar

Pretendimi ankimor nr. 4 : Në këtë pretendim ankimor, OE ankues konteston vlefshmërinë e ofertës së OE-së së shpallur fitues, duke pretenduar se dokumentet zyrtare të ofertës, përfshirë Deklaratën Nën Betim, janë nënshkruar nga një person i paautorizuar, konkretisht z. Vllaznim Vuçiterna, i cili nuk figuron si përfaqësues apo pronar i regjistruar në ARBK për kompaninë AGEO&CO SHPK.

OE ankues thekson se sipas ekstraktit të ARBK-së, pronar dhe përfaqësues i vetëm i autorizuar është z. Kujtim Vuçiterna, dhe se nuk ka asnjë dokument në dosjen e ofertës që dëshmon se z. Vllaznim Vuçiterna është i autorizuar për të nënshkruar dokumentet zyrtare të tenderit në emër të OE-së ofertues.

Sipas ankuesit, një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 109 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe me praktikën e konfirmuar nga KRPP në Opinionin Nr. 14 të datës 24.10.2023,

OE ankues konsideron se mungesa e një autorizimi të tillë ligjor përbën mangësi të rëndë formale dhe përmbajtësore, dhe si e tillë duhet të çojë në pavlefshmëri të ofertës së OE-së së shpallur fitues. Prandaj, kërkon që kjo çështje të trajtohet me seriozitet dhe të rivlerësohet përputhshmëria e ofertës me kërkesat ligjore dhe standardet e tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor Nr. 4: Në cilësinë e ekspertit shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit të ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë nga Autoriteti Kontraktues, konkretisht Ankesit Nr. 2 – Deklarata Nën Betim, si dhe bazuar në përmbajtjen e informacioneve zyrtare të ARBK-së dhe opinionin e KRPP-së Nr. 14 të datës 24.10.2023, jap vlerësimin si më poshtë:

Sipas dokumentacionit të dorëzuar në ofertë, Deklarata Nën Betim është nënshkruar nga z. Vllaznim Vuçiterna, ndërkohë që nga të dhënat zyrtare të ARBK-së rezulton se përfaqësues dhe pronar i vetëm i OE-së është z. Kujtim Vuçiterna, i cili figuron si personi i autorizuar për të vepruar në emër të biznesit. Nga përmbajtja e ofertës nuk rezulton të jetë dorëzuar asnjë dokument autorizimi që do t'i mundësonte z. Vllaznim Vuçiterna të nënshkruajë Deklaratën Nën Betim dhe/ose dokumente të tjera zyrtare në emër të OE-së ofertues.

Në këtë rrethanë, vlerësoj se pretendimi ankimor i paraqitur nga OE ankues është i bazuar, pasi nënshkrimi i dokumenteve zyrtare nga një person jo i autorizuar, pa ndonjë dëshmi përkatëse të autorizimit ligjor, bie në kundërshtim me kërkesat standarde të formularëve të tenderit dhe me praktikën e përcaktuar në Opinionin e KRPP-së Nr. 14 të datës 24.10.2023.

Sipas këtij opinion, edhe pse çështja e autorizimit nuk është e rregulluar specifikisht në dispozitat e LPP-së, KRPP thekson qartë se:

“...formularët standard, përfshirë Deklaratën nën Betim, duhet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i OE-së, dhe jo nga një person tjetër pa autorizim të vlefshëm.”

Në mungesë të një autorizimi të tillë, vlerësoj se Autoriteti Kontraktues ka tejkaluar standardin e vlefshmërisë së dokumenteve të ofertës duke konsideruar të vlefshëm nënshkrimin nga një person jo kompetent, çka përbën shkelje të parimit të barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomikë, si dhe vendos në pozitë të pabarabartë OE-të që kanë respektuar në përpikëri kërkesat ligjore për përfaqësim.

Bazuar në sa u tha më sipër, vlerësoj se pretendimi ankimor është bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “GJEO-PROJEKT” SH.P.K, te aprovet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “024 Blerja e paisjeve Gjeodezike per nevoja te DPKSHP-së” me nr. të prokurimit: 635-25-3196-1-2-1, të anulohet njoftimi per dhënie te kontratës dhe aktiviteti i prokurimit duhet te anulohet në mungesë të ofertave të përgjegjshme. Nëse autoriteti kontraktues ka interes këtë aktivitet të prokurimit **mund ta ri-tenderoj**.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit te anulohet.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - GJEO-PROJEKT SH.P.K**
- Arkivës së OSHP-së: